



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 3 dhe 4 Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.01.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

## V E N D I M

### PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB

#### Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Lipjanit , (në vazhdim të tekstit KKSBB), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës –Kryesues i KKSBB-së
2. Naser Sinani, Komandant i Stacionit Policor,
3. Zaim Baftiu, Bashkësia Islame
4. Dragisha Jerinic, Kisha ortodokse
5. Don Mateje Paliq, Kisha katolike
6. Fahrije Llugiqi, Komuniteti shqiptar
7. Zoran Radiq, Komuniteti serb
8. Alush Bikliqi, Komuniteti turk
9. Perparim Rexhepi, Komuniteti ashkali
10. Maksut Gashi, Komuniteti, rom
11. Goleme Petar Franjo, Komuniteti kroat
12. \_\_\_\_\_, Kryesuesi i komitetit për komunitete
13. Gjyste Dabaj, Zyra për barazi gjinore
14. Rasim Hasani , Drejtori i Drejtoratit për Arsim
15. Milazim Sadiku, Kryetar i Këshillit të prindërve
16. Kap. Fejzullah Fejzullahu, Përfaqësues nga FSK
17. Fehmi Gajtani, Këshilli Lokal për siguri publike
18. Haqif Rustemi, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
19. Imer Rustemi, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim  
Sektori i emergjencave civile

20. Zoran Stanojvic, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

21. Bekim Krasniqi nga OJQ YAHR , Përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

## Neni 2

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson Nënkrjetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siq i ka Kryesuesi i KKSBB-së.

## Neni 3

Mandati i anëtarëve të KKSBB-së është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

## Neni 4

Detyrat, përgjegjësitë , mbledhjet dhe çështjet tjera që lidhen me punën e KKSBB-së janë të përcaktuara me dispozitat e Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

## Neni 5

Për punën e tyre anëtarët e KKSBB-së paguhën nga buxheti Komunës. Kompensimi për anëtarët e KKSBB-së për pjesëmarrje në takime, bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kompensimi për pjesëmarrje në takimet e KKSBB-së bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të mbajtura brenda vitit kalendarik.

## Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 020-6049

Lipjan, më 31.01.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

